



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROJEKTEVE NË FUSHËN E
DREJTËSISË, INTEGRIMIT DHE NEGOCIATAVE
DREJTORIA E PROJEKTEVE NË FUSHËN E DREJTËSISË

Nr. 5784/1 Prot.

Tiranë, më 06.10.2023

URDHËR

Nr. 583, datë 06.10.2023

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KOORDINIMIN E NDIHMËS SË HUAJ”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, date 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullores për koordinimin e ndihmës së huaj”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Të gjitha institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, marrin masa që të kenë një strukturë përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj në strukturën ekzistuese, sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësisë së institucionit përkatës.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, Integrimit dhe Negociatave në Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjitha institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.
4. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr.149 datë 20.04.2022 "Për organizimin dhe bashkërendimin e punës në kuadër të ndjekjes së detyrave për menaxhimin e projekteve të fondeve IPA dhe donatorëve të tjerë, në funksion të sistemit të drejtësisë, në ministrinë e drejtësisë" shfuqizohet.
5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROJEKTEVE NË FUSHËN E
DREJTËSISË, INTEGRIMIT DHE NEGOCIATAVE
DREJTORIA E PROJEKTEVE NË FUSHËN E DREJTËSISË

RREGULLORE

“PËR KOORDINIMIN E NDIHMËS SË HUAJ”

Miratuar me Urdhrin nr. _____, datë ____/____/2023 të Ministrit të Drejtësisë

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme për bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), koordinimin e ndihmës së huaj sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, hartëzimin e projekteve, koordinimin me donatorët dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore synon të ndajë rolet, përgjegjësitë dhe funksionet e të gjitha strukturave të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve në varësi të saj për koordinimin e ndihmës së huaj dhe mënyrën e bashkëpunimit me institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë në fushën e koordinimit të donatorëve me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së procesit si dhe rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së strukturave të përfshira në këtë proces.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të gjitha procedurat e:

- a) programimit dhe negocimit të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të instrumentit të Para-Aderimit (IPA);
- b) zbatimit dhe raportimit të projekteve të zbatuara në kuadër të IPA-s;
- c) përgatitjes së projekteve të mbështetura nga donatorë të tjerë, të ndryshëm nga IPA;
- ç) zbatimit dhe raportimit të projekteve të mbështetura nga donatorë të tjerë, të ndryshëm nga IPA;
- d) hartëzimit të donatorëve dhe projekteve;
- dh) koordinimit të donatorëve dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Neni 4

Strukturat përgjegjëse

Strukturat përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj për sistemin e drejtësisë janë:

- a) Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj;
- b) Sekretari i Përgjithshëm;

- c) Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, e drejtuar nga Drejtori i cili është njëkohësisht edhe Zyrtari i Lartë i Programit në Ministrinë e Drejtësisë;
- ç) çdo strukturë tjetër në Ministrinë e Drejtësisë, sipas rastit;
- d) titullari i institucionit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë;
- dh) struktura përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj, në institucionet nën varësi të Ministrisë së Drejtësisë;

Neni 5

Menaxhimi i projekteve të financuara nga IPA dhe donatorëve të tjerë

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë është struktura përgjegjëse për koordinimin e të gjitha procedurave të përmendura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje për të gjitha drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë, institucionet në varësi të saj dhe institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë.
2. Në përmbushje të përgjegjësisë të saj, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë kërkon, sipas rastit, përfshirjen e drejtorive të tjera të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë së saj, në mbështetje të realizimit të këtyre proceseve dhe lehtëson bashkëpunimin me institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë.

KREU II

PROGRAMIMI I PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA IPA

Neni 6

Identifikimi i prioriteteve

1. Pas njoftimit zyrtar të dërguar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), në lidhje me afatet e brendshme të analizimit dhe identifikimit të prioriteteve, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë nëpërmjet Zëvendësministrit përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj dhe Sekretarit të Përgjithshëm, njofton të gjitha strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, institucionet në varësi të saj dhe institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë për afatin e vendosur nga SASPAC dhe u kërkon të identifikojnë prioritetet dhe nevojat e tyre për mbështetje me ndihmë të huaj.
2. Strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucionet në varësi të saj përcjellin informacionin e kërkuar sipas pikës 1 të këtij neni pranë Drejtorisë së Projekteve në Fushën e Drejtësisë brenda afatit të përcaktuar nga Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë.
3. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, bazuar në informacionin e ardhur nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, institucionet në varësi të saj dhe institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, sipas propozimit të strukturave dhe institucioneve harton listën e prioriteteve dhe e përcjell atë për rishikim tek Sekretari i Përgjithshëm dhe më pas tek Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj.

4. Në shqyrtimin e prioriteteve, Ministri i Drejtësisë merr në konsideratë Objektivat Strategjike të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe raportet e monitorimit të projekteve të financuara nga IPA dhe nga donatorë të tjerë.
5. Pas reflektimit të komenteve dhe vërejtjeve të Zëvendësministrit përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj dhe të Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë e dërgon listën e prioriteteve për miratim përfundimtar tek Ministri i Drejtësisë. Në rastet kur propozohet ndryshimi i prioriteteve të propozuara nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, Ministri i Drejtësisë i Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj i informon dhe u jep institucioneve të pavarura mundësinë për të dhënë arsytim shtesë për prioritetet e propozuara për përfitimin e ndihmës së huaj brenda afatit të përcaktuar nga Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë. Nëse institucioni i pavarur nuk paraqet arsye shtesë brenda këtij afati atëherë prioritetet e ndryshuara konsiderohen të pranuar nga institucioni i pavarur.
6. Lista e prioriteteve të miratuara i dërgohet SASPAC.

Neni 7

Përgatitja e projekt-fishave

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, bazuar në propozimet e bëra, bashkëpunon me Strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, institucionet në varësi të saj dhe institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, për hartimin e projekt-fishave në përputhje me metodologjinë e dërguar nga SASPAC.
2. Duke siguruar bashkëpunimin me strukturat respektive të Ministrisë së Drejtësisë, institucionet në varësi të saj dhe institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë për hartimin e projekt-fishave, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme në nivel teknik me SASPAC deri në përfundimin e projekt-fishave.
3. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë i dërgon për miratim projekt-fishat e hartuara, sipas hierarkisë përkatëse, tek Sekretari të Përgjithshëm, Zëvendësministri dhe Ministri. Në rastet kur propozohen ndryshime në projekt-fishat e propozuara nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj i informon dhe u jep institucioneve të pavarura mundësinë për të dhënë komentet e tij mbi ndryshimet e propozuara brenda afatit të përcaktuar nga Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë. Nëse institucioni i pavarur nuk paraqet komente brenda këtij afati atëherë projekt-fishat e ndryshuara konsiderohen të pranuar nga institucioni i pavarur.
4. Pas miratimit nga Ministri, projekt-fishat dërgohen pranë SASPAC.
5. Gjatë realizimit të detyrave të parashikuara në këtë Kre, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, informon në mënyrë të vazhdueshme Sekretarin e Përgjithshëm Zëvendësministrin përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj dhe Ministrin.

KREU III

RAPORTIMI I PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA IPA

Neni 8

Raportimi i projekteve që financohen nga IPA në Komitetet Sektoriale IPA

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, pas marrjes së njoftimit nga SASPAC për datën e organizimit të Komitetit Sektorial IPA, formatin e raportimit dhe afatin përfundimtar të përgatitjes së materialit, i dërgon shkresë zyrtare (ose email) strukturave brenda Ministrisë së Drejtësisë, të gjitha institucioneve në varësi të saj dhe institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë të cilat kanë në zbatim projekte IPA, duke përcaktuar afate konkrete për dërgimin e informacionit prej tyre, sipas formatit të komunikuar nga SASPAC, pranë Drejtorisë së Projekteve në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, pas mbledhjes së informacionit sipas pikës 1 të këtij neni, përgatit draft Raportin për Komitetin Sektorial IPA, të cilin e dërgon për komente apo sugjerime pranë Zëvendësministrit përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj.
3. Pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë i pasqyron ato në projekt raportin përfundimtar për Komitetin Sektorial IPA. Në rastet kur propozohen ndryshime në kontributin e dërguar nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj i informon dhe u jep institucioneve të pavarura mundësinë për të dhënë komentet e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë. Nëse institucioni i pavarur nuk paraqet komente brenda këtij afati atëherë kontributi i ndryshuar konsiderohet i pranuar nga institucioni i pavarur.
4. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë përgatit raportin përfundimtar dhe e dërgon për miratim tek Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj.
5. Pas miratimit të raportit përfundimtar nga Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë e dërgon atë pranë SASPAC, brenda afatit të përcaktuar prej tyre.
6. Pas përfundimit të Komitetit Sektorial IPA, Zyrtari i Lartë i Programit merr nga SASPAC konkluzionet operationale të Komitetit Sektorial IPA. Konkluzionet operationale do të shpërbejnë për të përgatitur raportin për Komitetin Sektorial IPA pasardhës lidhur me hapat e ndërmarrë për zbatimin e tyre.

Neni 9

Hartimi i Raportit Vjetor për zbatimin e IPA

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, pas marrjes së njoftimit nga SASPAC mbi formatin e raportimit dhe afatin e dorëzimit të raportit vjetor të zbatimit të projekteve të financuara nga IPA, i dërgon shkresë zyrtare (ose email) strukturave brenda Ministrisë së Drejtësisë, të gjitha institucioneve në varësi të saj dhe institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë të cilat kanë në zbatim projekte IPA duke u përcaktuar afate konkrete brenda të cilave duhet të dërgojnë pranë Drejtorisë së Projekteve në Fushën e Drejtësisë kontributin e tyre për Raportin Vjetor.

2. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, pas mbledhjes së informacionit sipas pikës 1 të këtij neni, përgatit draft raportin vjetor të zbatimit të projekteve IPA dhe e dërgon atë për komente apo sugjerime tek Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj.
3. Pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, pasqyron komentet apo sugjerimet e dhëna në projekt Raportin Vjetor. Në rastet kur propozohen ndryshime në kontributin e dërguar nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj i informon dhe u jep institucioneve të pavarura mundësinë për të dhënë komentet e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë. Nëse institucioni i pavarur nuk paraqet komente brenda këtij afati atëherë kontributi i ndryshuar konsiderohet i pranuar nga institucioni i pavarur.
4. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë përgatit raportin përfundimtar dhe e dërgon për miratim tek Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj.
5. Pas miratimit të raportit përfundimtar nga Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë e dërgon atë pranë SASAPAC brenda afatit të përcaktuar prej tyre.

KREU IV

PËRGATITJA E PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA DONATORË TË TJERË

Neni 10

Vlerësimi i projekt-idesë

1. Çdo drejtori brenda Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose çdo institucion në varësi të saj që kërkon të zbatojë një projekt me financim të huaj të ndryshëm nga fondet IPA, konsulton për këtë qëllim Drejtorinë e Projekteve në Fushën e Drejtësisë duke i paraqitur projekt-idenë të hartuar sipas formatit të miratuar për këtë qëllim, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC dhe kërkon miratimin e projekt-idesë së konsultuar nga Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj.
2. Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj vlerëson përputhshmërinë e projekt-idesë me politikat e Ministrisë së Drejtësisë dhe miraton ose jo vazhdimin e procedurës së aplikimit për financim nga drejtoria ose institucioni në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 11

Hartimi i projekt-propozimit

Drejtorja brenda Ministrisë së Drejtësisë ose institucioni në varësi të saj që ka marrë miratimin për vijim e procedurës së aplikimit, mund të kërkojë ndihmën e Drejtorisë së Projekteve në Fushën e Drejtësisë, për zhvillimin e paketës së aplikimit, identifikimin e donatorit apo për vendosjen e kontakteve me një donator të mundshëm.

Neni 12
Informimi i Ministrisë së Drejtësisë

1. Institucioni në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që ka nënshkruar një marrëveshje me një donator të huaj për financimin e një projekti, dërgon në Drejtorinë e Projekteve në Fushën e Drejtësisë kopje të kontratës së nënshkruar së bashku me anekset përkatëse dhe dokumentet e tjera me rëndësi për projektin që financohet.

KREU V
RAPORTIMI I PROJEKTEVE TË CILAT FINANCOHEN NGA DONATORË TË TJERË

Neni 13
Afatet dhe formatet e raportimit

1. Drejtoria brenda Ministrisë së Drejtësisë ose çdo institucion në varësi të saj, që po zbaton/përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e një projekti, informon sa herë kërkohet dhe në çdo rast, brenda muajit dhjetor dhe qershor të çdo viti, Drejtorinë e Projekteve në Fushën e Drejtësisë mbi:
- a) listën e përditësuar të projekteve me financim të huaj që janë në zbatim, strukturat/njësitë përgjegjëse përkatëse të projekteve në fjalë si dhe personat e autorizuar për menaxhimin e këtyre projekteve;
 - b) planin vjetor të aktiviteteve dhe planifikimin e shpenzimeve ose planin e prokurimeve për çdo projekt të raportuar në shkronjën a) të kësaj pike;
 - c) statusin e zbatimit të aktiviteteve dhe ecurinë financiare të projekteve që janë në zbatim;
 - ç) zbatimin e aktiviteteve dhe ecurinë financiare për çdo projekt të përfunduar të raportuar në shkronjën a) të kësaj pike;
 - d) lidhjen e projektit që synohet të zbatohet me financim të huaj ose që është duke u zbatuar me financim të huaj me Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë, për çdo projekt të raportuar në shkronjën a) të kësaj pike.
2. Informacioni i kërkuar sipas pikës 4 më sipër dërgohet në Drejtorinë e Projekteve në Fushën e Drejtësisë në përputhje me formatet e raportimit të miratuara për këtë qëllim me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC.

Neni 14

Afatet dhe formatet e raportimit për institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë

Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC mbi afatet dhe formatet e raportimit për projektet e financuara nga donatorë të tjerë të ndryshëm nga IPA, i dërgon shkresë zyrtare (ose email) institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë të cilat kanë në zbatim ose janë përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e një projekti të financuar nga donatorë të tjerë të ndryshëm nga IPA duke i informuar ata mbi detyrimin për të raportuar mbi ato projekte në përputhje me afatet dhe formatet e përcaktuara nga SASPAC.

KREU VI

HARTA E PROJEKTEVE

Neni 15

Harta e projekteve

1. Bazuar në informacionin e mbledhur sipas neneve 8, 9, 12, 13 dhe 14 të kësaj Rregulloreje, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë përgatit një hartë të projekteve të planifikuara dhe një hartë të projekteve që janë në zbatim nga çdo drejtori brenda Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose çdo institucion në varësi të saj ose institucion i pavarur i sistemit të drejtësisë.
2. Harta e projekteve të planifikuara dhe projekteve në zbatim, plotësohet sipas tabelës 1 bashkëlidhur në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.
3. Nëse informacioni i mbledhur sipas neneve 8, 9, 12, 13 dhe 14 të kësaj Rregulloreje nuk mjafton për të plotësuar hartat e projekteve të planifikuara ose në zbatim, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë kontakton me email dhe e merr informacionin nga drejtoria brenda Ministrisë së Drejtësisë, institucioni në varësi të saj ose institucioni i pavarur i sistemit të drejtësisë që posedon atë informacion.

Neni 16

Përditësimi i hartës së projekteve

1. Harta e projekteve të planifikuara dhe projekteve në zbatim përditësohet nga Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, sa herë që ndodh një ndryshim në statusin e një projekti të caktuar, por jo më pak se 2 herë në vit, më 30 janar dhe 30 korrik të çdo viti.
2. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë ndan hartën e përditësuar të projekteve në zbatim ose të planifikuara me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Zëvendësministrin përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, sipas kërkesës ose të paktën në shkurt dhe gusht të çdo viti.
3. Çdo drejtori brenda Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose çdo institucion në varësi të saj njofton menjëherë Drejtorinë e Projekteve në Fushën e Drejtësisë për çdo ndryshim në statusin e një

projekti të planifikuar ose në zbatim prej saj ose për çdo ndryshim që prek punonjës të përgjegjës për projektet brenda institucionit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë apo të dhënave të kontaktit.

4. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë kërkon periodikisht informacion nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë për çdo ndryshim në statusin e një projekti të planifikuar ose në zbatim prej tij ose për çdo ndryshim që prek punonjës të përgjegjës për projektet brenda institucionit të pavarur apo të dhënave të tij/saj të kontaktit.

5. Sa herë që Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë ka nevojë për informacion për një projekt të caktuar dhe atë informacion nuk e merr nga drejtoritë brenda Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose çdo institucion në varësi të saj si dhe nga institucionet e pavarura, kontakton për këtë qëllim donatorin përkatës.

KREU VII KOORDINIMI I DONATORËVE

Neni 17

Lista e projekteve të përfunduara

Në çdo rast kur Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë merr informacion se një projekt ka përfunduar, e heq atë nga harta e projekteve dhe e vendos atë në një listë të projekteve të përfunduara, sipas Tabelës 3 bashkëlidhur Aneksit I të kësaj Rregulloreje.

Neni 18

Roli i Drejtorisë së Projekteve në Fushën e Drejtësisë

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, me qëllim koordinimin e donatorëve dhe projekteve, kryen këto funksione:
 - a. siguron koordinimin dhe komunikimin mes donatorëve dhe mes donatorëve e çdo drejtorie brenda Ministrisë së Drejtësisë, çdo institucioni në varësi të saj dhe institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë;
 - b. mban kontakte të vazhdueshme në nivel teknik me donatorët të cilët mbështesin me financim projekte ose investime në fushën e drejtësisë;
 - c. mban kontakte të vazhdueshme në nivel teknik me punonjësit përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj në institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë;
 - d. organizon, jo më pak se 2 herë në vit, një takim koordinimi me rrjetin e punonjësve përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj në institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë;
 - e. sigurohet që punonjësit përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj në institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë kanë informacionin e nevojshëm në lidhje me mundësitë për të përfutur nga ndihma e huaj dhe detyrimet që lindin nga përfitimi i saj;

- f. evidenton nevojat dhe rekomandon format dhe mjetet për ngritjen e kapaciteteve teknike të rrjetit të punonjësve përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj në institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë.

Neni 19

Lista e donatorëve

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë mban dhe përditëson sipas nevojës, një listë të donatorëve të cilët mbështesin ose kanë mbështetur me financim projekte ose investime në fushën e drejtësisë.
2. Lista e donatorëve plotësohet sipas Tabelës 2 bashkëlidhur Aneksit I të kësaj Rregulloreje.
3. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë plotëson listën bazuar në informacionin e mbledhur nga informacioni i marrë gjatë zbatimit të neneve 8, 9, 12, 13 dhe 14 të kësaj Rregulloreje si nga kontakti i drejtpërdrejtë në nivel teknik me donatorët.
4. Lista e donatorëve përditësohet rregullisht, por jo më pak se 2 herë në vit, më 31 janar dhe 30 korrik, duke kontaktuar për këtë qëllim edhe donatorët që mbështesin ose kanë mbështetur me financim projekte ose investime në fushën e drejtësisë.

Neni 20

Takimi me donatorët

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë mbështet Zëvendësministrin përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj të organizojë, jo më pak se 1 herë në vit, një takim me donatorët të cilët kanë interes ose mbështesin, me financim, projekte ose investime në fushën e drejtësisë.
2. Takimi kryesohet nga Zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj dhe synon të informojë donatorët si dhe të mbledh informacion mbi:
 - a. projektet të cilat janë në zbatim në fushën e drejtësisë;
 - b. problematikat e hasura gjatë zbatimit të projekteve;
 - c. politikat e qeverisë/ministrisë në fushën e drejtësisë;
 - d. nevojat dhe hapësirat për mbështetje me projekte ose investime në fushën e drejtësisë;
 - e. planet dhe mundësitë e tyre për mbështetje projektesh ose financime në fushën e drejtësisë.

ANNEX I

TABLE 1 - MAP OF ONGOING AND PLANNED PROJECTS

Donor Mapping for Justice										
Table 1 - On going and planned projects										
No.	Beneficiary (Responsible Government Institution)	Project Title	Description / Key Objectives	Committed Funds (EUR)	Funding Donor(s)	Type of Finance	Implementor	Start Date	End Date	Project Status (Ongoing, Planned)
										Contact information of person at Implementing Agency/partner for detailed information
										CSS II Policy Objective (Specific Objective)
										Comments

TABLE 2 – LIST OF DONORS

Table 2 - List of Donors		
No	Donor	Contact details
		Comments

TABLE 3 – PAST PROJECTS PER DONOR

No.	Donor	Project Title	Invested Funds (EUR)	Type of Finance	Implementor	Comments